

GreenAL

Raport mbi tryezat e rrumbullakëta dhe takime me grupet e interesit

RAJONI QENDROR

Korrik, 2024.

Përmbledhje Narrative e Tryezave të Rrumbullakëta.

Gjatë Muajit Maj dhe Qershor 2024, në rajonin Qendror u zhvilluan katër (4) tryeza të rrumbullakëta nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në kuadër të Projektit GreenAL “Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile 2024 - 2027”. Tre tryeza rajonale u zhvilluan në qytetet kryesore të qarqeve të Rajonit Qëndror, konkretisht në qytetet Durrës, Elbasan, Fier dhe cikli i takimeve u përmbyll me tryezën kombëtare e cila u zhvilluan në qytetin e Tiranës.

Gjatë këtyre tryezave u bë prezantimi i projektit GreenAL, duke u ndalur tek objektivat kryesore, grupet e interesit, tematikat në të cilat do përqëndrohet GreenAL, mundësitë e financimit për organizatat pjesëmarrëse, kohështrirja e projektit, çështjet gjinore, si dhe mbështetja tematike që do t’i ofrohet OSHC-ve mjedisore nëpërmjet këtij projekti. Pjesëmarrësit në tryeza gjithashtu morën informacion në lidhje me faqen e internetit dhe rrjetet sociale të projektit GreenAL (greenal.al), të cilët do të ndihmojnë në promovimin e punës së OSHC-ve mjedisore, si dhe në procesin e monitorimit të ndotjes akustike, të ajrit, ujit e tokës.

Tryezat e rrumbullakët gjithashtu shërbyen si hapsira për të parashtruar çështjet mjedisore me interes për projektin GreenAL, të cilat janë në përputhje të marrëveshjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, dhe për të diskutuar me pjesëmarrësit problematikat mjedisore me të cilat ata po përballen, si dhe zgjidhje të mundshme që ata mendojnë se mund të implementojnë.

Më poshtë janë të pasqyruara çështjet e diskutuara për secilën tryezë dhe një përshkrim i shkurtër i pjesëmarrësve.

Tryeza e Rrumbullakët në Durrës

Gjatë Tryezës së Rrumbullakët në Qytetin e Durrësit pjesëmarrësit sollën në vëmendje disa problematika mjedisore dhe disa sygjerime në lidhje me projektin GreenAL.

OSHC-të lokale të qytetit të Durrësit përballen me problemin se projektet fitohen nga OSHC të cilat nuk janë lokale dhe shpesh herë zbatimi i këtyre projekteve bëhet vetëm për të përmbushur detyrimet që kanë organizatat zbatuese, duke mos përfshirë organizatat lokale apo komunitetin. Nga ana e pjesëmarrësve u kërkua që në kriteret e përzgjedhjes së OSHC-ve fituese të jetë kusht përfshirja e OSHC-ve lokale dhe komunitetit.

Pjesëmarrësit sygjerman që projekti GreenAL të përfshijë në kriteret e kualifikimit/të thirrjeve në të cilat do të kërkohet aplikimi me partner, përfshirjen e organizatave lokale si pjesë organike e zbatimit të projektit. Ata theksuan se përfshirja e OSHC-ve lokale do të ishte vlerë e shtuar për GreenAL për faktin se organizatat lokale kanë më shumë kontakte lokale dhe përfshirja e komunitetit do të rrisë ndjeshmërinë dhe angazhimin e tyre në ruajtjen dhe vazhdimin e përfitimeve të projektit. Për më tepër bashkëpunimi mes organizatave të niveleve të ndryshme do të ndihmonte OSHC-të lokale në rritjen e kapaciteteve të tyre.

OSHC-të lokale kërkuan që në fazën e aplikimeve të merren në konsideratë edhe OSHC-të që kanë eksperience në çështjet mjedisore, por që nuk e kanë të përfshirë në statutin e tyre fokusin në mjedis dhe mbrojtjen e promovimin e habitateve. Kjo pasi OSHC-të lokale kanë tendencën të ndryshojnë drejtimin e fokusit të tyre drejtë nevojave të komunitetit, shpesh herë duke zbatuar projekte përtej statutit të tyre dhe duke fituar eksperience në fusha të tjera.

Si pjesë e diskutimeve u soll dhe rëndësia e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së peisazheve të mbrojtur dhe monumenteve të kulturës, me qëllim promovimin e turizmit dhe mbrojtjen e natyrës, dhe duke patur parasysh që monumentet e natyrës ndikohen lehtësisht nga efektet e ndryshimeve klimatike, erozioni,

tërmetet, etj. Pjesëmarrësit kërkuar të dinin nëse do të pranoheshin në thirrje aplikime për projekte të cilat do ndihmonin në ruajtjen e monumenteve të kulturës dhe peisazheve të mbrojtura. Grupi i punës sqaroi që për sa kohë fokusi kryesor i projektit mbetet tek një nga tri tematikat kryesore të GreenAL (Ndryshimet Klimatike, Ndotja dhe Natyra), atëherë projekte që do të përfshinin edhe mbrojtjen e monumenteve të natyrës apo peisazheve e zonave të mbrojtura mund të mbështeten nëpërmjet GreenAL. U theksua se këto lloj nismash jo vetëm që do të ndihmojnë në tërheqjen e turistëve, por gjithashtu do të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për ruajtjen dhe vlerësimin e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore.

Një tjetër problematikë që u soll në tryezë ishte dhe mungesa e vëmëndjes që i kushton Bashkia Durrës pastrimit dhe monitorimit të kanaleve kullues në zonën e ish – Kënetës. Zona e ish – Kënetës është një zonë informale e mbipopulluar dhe me shumë problematika, ku kanalet kullues, që më parë kishin fokus bujqësor, kanë ndryshuar funksionin e tyre dhe tani në to shkarkohen ujërat e ndotura urbane, kjo për shkak se zona nuk ka kanalizime për ujërat e ndotura urbane. Gjithashtu në kanalet kullues hidhen dhe mbetje urbane, për shkak të mungesës së koshave të mbetjeve urbane.

Një nga pjesëmarrësit e takimit theksoj se ndërgjegjësimi i komunitetit në lidhje me rëndësinë e mbajtjes pastër të kanaleve kullues, krijimin e planeve për monitorimin dhe mirëmbajtjen e tyre, apo marrja e nismave për të legjitimuar procesin e tërheqjes së mbetjeve urbane në zonën e ish – Kënetës dhe procesit të pastimit rutinë të kanaleve, do të sillnin në këtë zonë një ndikim pozitiv.

Tryeza e Rrumbullakët në Elbasan

Temat më të diskutuara që GreenAL hasi në Tryezën e Rrumbullakët në qytetin e Elbasanit ishin ndotja, humbja e biodiversitetit dhe pyjet.

Pjesëmarrësit në tryezë informuan që liqeni i Belshit aktualisht është i ndotur, por nuk ka një informacion të saktë për nivelin e ndotjes së tij dhe as plane për të bërë pastrimin e tij. Ndotja e Liqenit të Belshit është një çështje e rëndësishme për ekosistemin dhe për mirëqenien e komunitetit lokal pasi gjatë viteve të fundit ai është bërë një destinacion turistik dhe pret një numër të konsiderueshëm turistësh shqiptarë dhe të huaj. Për të adresuar këtë problem, pjesëmarrësit propozuan që të zhvillohet një plan veprimi i përbashkët mes autoriteteve lokale, organizatave jo-qeveritare dhe biznesit lokal për monitorimin e cilësisë së ujit, identifikimin e burimeve të ndotjes dhe ndërmarrjen e masave korigjuese për të përmirësuar cilësinë e ujit.

Mungesa e infrastrukturës për depozitim dhe evadimin e mbetjeve urbane në zonat e mbrojtura është një problem tjetër me të cilin ndeshen OSHC-të dhe komuniteti i qarkut Elbasan. Përdorimi i zonave të rekreacionit prej vitesh dhe mungesa e infrastrukturës për tërheqjen e mbetjeve, ka bërë që të ketë mbetje të grumbulluara në zona të ndryshme turistike. Përveç zonave të mbrojtura apo pyjeve, vërehet i njëjti problem edhe në zonat rurale. Për të udhëtuar drejtë destinacioneve turistike, të gjithë kalojnë nëpër fshatra e qytete të ndryshme dhe përveç qendrës së qytetit duhet të mbahen paster dhe të gjithë zonat ku kalojnë turistët për të arritur destinacionin.

Pjesëmarrësit informuan që për të përmirësuar situatën, duhet të ndërmerren hapa për të rregulluar infrastrukturën dhe për të ndërgjegjësuar komunitetin për rëndësinë e trajtimit të mbetjeve në mënyrë të përshtatshme.

Një tjetër shqetësim i ngritur nga pjesëmarrësit ishte ndërtimi i hidrocentraleve. Ndonëse të rëndësishme për prodhimin e energjisë së rinovueshme, ato kanë ndikime negative në ekosistemet ujore, pasi ndryshimi i rrjedhës së ujit mund të shkaktojë humbjen e habitatit dhe të rrezikoj faunën ujore.

Për të zvogëluar këtë ndikim, u rekomandua ndërmarrja e hapave si ndryshimi i vëllimit të rrjedhës së ujit, përmirësimi i infrastrukturës së kalimit të peshkut, monitorimi i vdekshmërisë së peshkut dhe përmirësimi i habitatit të dëmtuar.

Një ndër problemet më të përgjithshëm në sipërfaqet pyjore në Shqipëri e cila u ngrit nga pjesëmarrësit është prerja e pakontrolluar e pyjeve, një fenomen i cili ka dobësuar habitatin natyror pyjor dhe ka bërë që këto habitate të pushtohen nga bimësi invazive jo tipike për zonat.

Një qasje e efektshme për menaxhimin e këtij problemi do të ishte hartimi i planeve të menaxhimit të pyjeve, si monitorimi i tyre i vazhdueshëm dhe identifikimi i zonave me rrezikshmëri të lartë. Përhapja e specieve invazive mund të kontrollohet me ndërhyrje më praktike, si mbjellja e specieve autoktone për të zvogëluar konkurrencën. Gjithashtu, nxitja e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe e edukimit për biodiversitetin e zonës mund të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit për mbrojtjen e habitatit natyror.

Në qarkun e Elbasanit ka disa fshatra të cilat janë pjesë e projektit 100 Fshatrat, ndër to në tryezë u diskutua për Stëblevën, e cila përballë cdo ditë dhe me shumë me largimin e popullësisë, kryesisht rinisë. Ky është një fenomen i cili po ndikon cdo ditë dhe më shumë të gjitha zonat rurale të Shqipërisë dhe ka ndikim në të gjitha fushat. Nga pjesëmarrësit u sygjera, që për të ndihmuar në uljen e numrit të largimeve, pjesëmarrja e rinisë në projektet të cilat kanë në fokus mjedisin, mbrojtjen e pyjeve, zhvillimin e turizmit dhe menaxhimin e mbetjeve. Kjo do të sillte një burim të ri idesh dhe energjish për të përmirësuar gjendjen e mjedisit.

Tryeza e Rrumbullakët në Fier

Tryeza e rrumbullakët në qytetin e Fierit solli bashkë shumë aktorë të ndryshëm të shoqërisë, si përfaqësues të Bashkive të qarkut, OSHC lokale, agjencinë e zonave të mbrojtura, komunitetit, shkollat, etj. dhe u diskutuan tematikat më problematike në fushën e mjedisit.

Ndër problematikat e para të përmendura ishte zjarri në pyllin e Pishë Poros, pjesë e Pejshazhit të Mbrojtur Pishë Poro – Nartë, përgjatë vitit të kaluar, rezultoi në më shumë se 700 ha sipërfaqe pyjore të shkrumbuar. Për të mbrojtur dhe rindërtuar pyllin e Pishë Poros, u theksua se është i nevojshëm krijimi i një strategjie të përbashkët që përfshin masat për parandalimin e zjarreve, restaurimin e dëmeve të shkaktuara, dhe rindërtimin e habitatit natyror.

Gjatë takimit gjithashtu u theksua nevoja për të adresuar ndotjen nga hidrokarburet në zonën e Patos-Marinzës, e cila përbën një kërcënim serioz për shëndetin e komunitetit dhe për ekosistemin e zonës. (Fusha e Patos-Marinzës është një nga 31 zonat e nxehta në Shqipëri.)

Për të adresuar ndotjen nga hidrokarburet, pjesëmarrësit dakortësuan për rëndësinë e zhvillimit një plani për menaxhimin e ndotjes, monitorimin e niveleve të ndotjes, programet për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut mbi ndotjen nga hidrokarburet dhe rritjen e ndërgjegjësimit për të identifikuar dhe raportuar raste të ndotjes.

Ndotja e ujërave të pijshëm nga ujërat e ndotur urbane në Bashkinë e Lushnjës, si dhe shkarkimi i ujërave të ndotur urban në Lagunën e Karavastasë janë dy probleme që u sollën në tryezën e rrumbullakët nga përfaqësuesit e Bashkisë Lushnje. Gjatë takimit diskutua rëndësia e zgjidhjes së këtyre problemeve, pasi ndotja e ujërave të pijshëm paraqet rrezik për shëndetin publik, ndërsa shkarkimi i ujërave të ndotur urban në ujërat e lagunës dëmton dhe ndryshon ekosistemin e lagunës.

Për adresimin e këtyre problemeve, pjesëmarrësit informuan që është e nevojshme të ndërmerren nisma për hartimin e planeve të menaxhimit të ujërave për të evidentuar dhe monitoruar ndotjen e ujërave të pijshëm, apo të hartohen projekte të cilat masin nivelet e ndotjes dhe dëmet që mund të sjellë në

ekosistemin e lagunës , si dhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e komunitetit për rëndësinë e ruajtjes së lagunës.

Një ndër problematikat e tjera të hasura që u ngrit nga pjesëmarrësit ishte mungesa e sistemeve të kanalizimeve në Njësinë Administrative të Portëzë dhe në disa njësi të tjera administrative të qarkut Fier (kryesisht në zonat rurale të qytetit). Mungesa e kanalizimeve dhe grumbullimi i ujërave të ndotura urbane në gropa septike është diçka që po rrezikon ndotjen e burimeve ujore nëntokësore. Për të adresuar këtë problem, u theksua rëndësia e hartimit të një plani të integruar për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme të kanalizimeve dhe për të menaxhuar ujërat e ndotura në mënyrë më efektive. Gjithashtu, u vu në dukje rëndësia e ndërgjegjësimin dhe trajnimit të komunitetit në lidhje me rëndësinë e trajtimit të ujërave të ndotura. Për më tepër u sygjera që të bëhet matja e ndotjes së tokës, matja e ndotjes së burimeve ujore dhe identifikimi i rrezikut që kjo ndotje sjell tek shëndeti i komunitetit. Një fenomen shqetësues i ngritur gjatë takimit ishte ai i humbjes së sipërfaqes së rërës dhe përparimit të detit drejt tokave bujqësore, fenomen ky i cili po avancohet çdo vit dhe më shumë në zonën bregdetare ndërmjet grykëderdhjes së Semanit dhe të Darëzës. Për të ngadalësuar këtë proces pjesëmarrësit sygjera që do të ndihmonte mbrojtja e dunave ranore. Dunat ranore janë të rëndësishme për mbrojtjen e vijës bregdetare dhe ruajtjen e biodiversitetit. Ato ofrojnë një habitat unik për një shumëllojshmëri të madhe të bimëve dhe kafshëve dhe ndihmojnë në rregullimin e mikroklimës së zonës bregdetare. Gjithashtu u sygjera nevoja e hartimit të planeve të menaxhimit që përfshijnë monitorimin e rregullt, masat mbrojtëse të përshtatshme, rritja e ndërgjegjësimin dhe edukimi i komunitetit lokal për rëndësinë e dunave.

Në tryezë u diskutua gjithashtu vështirësia që bashkitë hasin për të bërë ndryshimet legislative që dëshirojnë, duke ndjerë shpesh se nuk kanë fuqi të kërkojnë përshtatje apo ndryshime. Kjo situatë nënvizon nevojën për një proces më të qartë dhe të përbashkët komunikimi ndërmjet bashkive dhe institucioneve qendrore për të adresuar dhe zbatuar ndryshimet e nevojshme legislative.

Tryeza e Rrumbullakët në Tiranë

Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në qytetin e Tiranës shprehën interes për projektin. Shumë nga çështjet e diskutuara kishin të bënin me sqarime të cilat i vinin në ndihmë OSHC-ve për të kuptuar tipologjitë e granteve që GreenAL ofron, apo procesin e përzgjedhjes së projekteve fituese.

Gjatë takimit u diskutua mundësia e angazhimit dhe zhvillimit të takimeve me përfaqësues të KKSHC si një nga mekanizmat që ofron Ligji "Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile" (Nr. 119/2015), që mund të shërbejë për të diskutuar dhe advokuar për çështjet mjedisore. Një mënyrë alternative institucionale e këtyre diskutimeve u propozua nga grupi i punës që mund të jetë dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian, (Ligj nr. 15/2015) "Për rolin e kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", që ka qëllim nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile. Shoqëria civile prezente e shikon me rezerva këtë nismë, për faktin se në të kaluarën bashkëpunimi ka qenë i veshtirë.

Diskutimet në këtë tryezë sollën vëmendjen në disa tema të ndryshme, si energjia e rinovueshme, menaxhimi i riskut, thatësia dhe nxehtësia, biodiversitetin, etj. Disa nga tematikat që pjesëmarrësit i shfaqën si çështje me interes për t'u mbështetur nga GreenAL ishin:

Projekte me në fokus energjinë e rinovueshme, kryesisht energjinë e prodhuar nga dielli;

Projekte në lidhje me menaxhimin e riskut ndaj fatkeqësive;

Projekte me në fokus thatësinë dhe nxehtësinë në zonat urbane dhe thatësinë dhe problematikat e bujqësisë në zonat rurale, si dhe shtimi i incidencës së zjarreve. Gjë që po bëhet më tepër evidente me shtimin e efekteve të ndryshimeve klimatike;

Projekte që ndalojnë prerjen e pakontrolluar të pyjeve dhe mbështesin nevojën për pyllëzimin e tyre; Projekte që shërbejnë për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe adresimin e pasojave që vijnë nga ndryshimet klimatike, si p.sh. ndryshime në sasinë e rreshjeve dhe rritje të menjëhershme të temperaturave, duke shkaktuar përmbytje dhe thatësira;

Projekte të cilat të masin qartë dëmet që HEC-et kanë në biodiversitet, që llojnë për adresimin e kësaj çështje dhe që krijojnë plane për restaurimin e habitateve;

Projekte që bëjnë ndërgjegjësimi i komuniteteve të zonës mbi ndërtimin e HEC-eve dhe dëmet që sjellin në biodiversitet.

Përgjatë diskutimit përfaqësues të OSHC-ve theksuan se gjatë punës së tyre ata kanë krijuar idenë që bashkitë jo gjithmonë kanë kapacitete teknike të zgjidhin problematikat me të cilat hasen. U sygjera nga grupi i punës që një mënyrë për të përdorur kapacitetet e OSHC-ve dhe për të krijuar bashkëpunim me bashkitë, do të ishte nëpërmjet dhënies së ekspertizës për krijimin e planeve të ndryshme, si planet për menaxhimin e riskut nga fatëkeqsitë, planet për menaxhimin e mbetjeve, planet për eficiencën e energjisë, etj.

Përfaqësuesja nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit shprehu se AKM është e hapur të bashkëpunojë me OSHC-të që do të shprehin interes.

Përfaqësuesit këshilluan që GreenAL të krijoj sinergji me EU4RIVERS dhe EU4NATURE meqenëse këto dy nisma kanë tematika të përbashkëta me disa nga temat e GreenAL. Krijimi i një sinergjie të tillë, do të shërbente për të shmangur dublikimin e projekteve dhe shmangien e projekteve që mund të bien ndesh me njëri tjetrin.

Përmbledhja e Pjesëmarrësve

Në tryezat e rrumbullakta të zhvilluara në qytetet Durrës, Elbasan, Fier dhe Tiranë morën pjesë një total prej 97 pjesëmarrësish, nga të cilët 32 ose 33% ishin burra dhe 65 ose 67% ishin gra. Vihet re se në tryezat e mbajtura, ka dallim midis numrit të pjesëmarrësve burra dhe gra. Në qytetet Durrës dhe Fier vërejmë një pjesëmarrje shumë të lartë të grave krahasuar me burrat. Në anën tjetër, qytetet Elbasan dhe Tiranë shfaqin një përfaqësim më të barabartë midis dy gjinive. Kjo situatë reflekton ndryshimet që vijnë nga karakteristikat dhe konteksti i çdo qyteti në rajon dhe sugjeron nevojën për të përshtatur iniciativat dhe politikat për të siguruar një përfshirje sa më të gjerë të gjinisë në diskutimet në fushën e mjedisit.

Në total u angazhuan në këto takime më shume se 55 aktorë lokal, rajonal e kombëtarë, nga të cilët mund të përmendim 35 organizata të shoqërisë civile, 3 shkolla, 8 bashki, 7 institucione rajonale apo kombëtare, etj.

Eventi	Numri pjesëmarrësve	i Burra	Gra
Durrës	17	3 (18%)	14 (82%)
Elbasan	9	5 (56%)	4 (44%)
Fier	33	9 (27%)	24 (73%)
Tiranë	38	15 (39%)	23 (61%)
Total	97	32 (33%)	65 (67%)

Rekomandime:

Këto takime synuan të mblidhnin informacione të vlefshme dhe të formulonin rekomandime për përmirësimin e procesit të menaxhimit mjedisor. Gjetjet nga këto tryeza do të udhëzojnë OSHC-të mjedisore, duke sygjëruar një qasje më efektive ndaj mbrojtjes mjedisore në të gjitha rajonet. Disa nga rekomandimet/gjetjet kryesore që mund të pëmdenden janë:

Për grante në të cilët do të kërkohet të aplikojnë më shumë se një partner, të merret në konsideratë edhe përfshirja e organizatave lokale si pjesë organike e zbatimit të projektit;

Edhe pse disa organizata nuk e kanë të përfshirë zyrtarisht mbrojtjen e mjedisit në statutin e tyre, të merret parasysh angazhimi i tyre në fushën mjedisore vitet e fundit gjatë vlerësimit të tyre në projekte të ardhshme;

Projekte me në fokus Ndryshimet Klimatike, Ndotjen dhe Natyrën, të cilat do të sillnin edhe mbrojtjen e monumenteve të natyrës apo peisazheve e zonave të mbrojtura, të mbështeten nga gratet e GreenAL; Ndërgjegjësimi i komunitetit në lidhje me rëndësinë e mbajtjes pastër të kanaleve kullues, krijimi i planeve për monitorimin dhe mirëmbajtjen e tyre, apo marrja e nismave për të legjitimuar procesin e tërheqjes së mbetjeve urbane në zonën e ish – Kënetës dhe procesit të pastimit rutinë të kanaleve; Zhvillimi i një plan veprimi të përbashkët mes autoriteteve lokale, organizatave jo-qeveritare dhe biznesit lokal për monitorimin e cilesisë së ujit, identifikimin e burimeve të ndotjes dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese për të përmirësuar cilesinë e ujit të liqenit Belsh;

Të ndërmerren hapa për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të ndërgjegjësuar komunitetin mbi rëndësinë e trajtimit të mbetjeve në mënyrë të përshtatshme, sidomos në zonat e mbrojtura;

Për habitatet e ndryshuara nga ndertimi i HEC është e rëndësishme të ndërmerren hapa si ndryshimi i vëllimit të rrjedhës së ujit, përmirësimi i infrastrukturës së kalimit të peshkut, monitorimi i vdekshmërisë së peshkut dhe përmirësimi i habitatit të dëmtuar;

Hartimi i planeve të menaxhimit të pyjeve, monitorimi i tyre i vazhdueshëm, identifikimi i zonave me rrezikshmëri të lartë, mbjellja e specieve autoktone për të zvogëluar konkurrencën, nxitja e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe e edukimit për biodiversitetin e zonës mund të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit për mbrojtjen e habitatit natyror;

Pjesëmarrja e rinisë në projektet që kanë në fokus mjedisin, mbrojtjen e pyjeve, zhvillimin e turizmit dhe menaxhimin e mbetjeve do të sillte një burim të ri idesh dhe energjesh për të përmirësuar gjendjen e mjedisit;

Për të mbrojtur dhe rindërtuar pyllin e Pishë Poros, është i nevojshëm krijimi i një strategjie të përbashkët që përfshin masat për parandalimin e zjarreve, restaurimin e dëmeve të shkaktuara, dhe rindërtimin e habitatit natyror;

Për të adresuar ndotjen nga hidrokarburet në fushën e Patos-Marinzës, është e rëndësishme të zhvillohet një plan i menaxhimit të ndotjes, monitorimi i niveleve të ndotjes, programet për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut mbi ndotjen nga hidrokarburet dhe rritjen e ndërgjegjësimit për të raportuar raste të ndotjes;

Do të ishte e nevojshme të ndërmerren nisma për hartimin e planeve të menaxhimit të ujërave për të evidentuar dhe monitoruar ndotjen e ujërave të pijshëm nga ujërat e ndotura urbane në bashkinë Lushnje;

Projekte të cilat do të matnin nivelet e ndotjes dhe dëmet që mund të sjellë në ekosistemin e lagunës së Karavastasë ndotja nga ujërat e ndotura urbane, si dhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit për rëndësinë e ruajtjes së burimeve ujore do të sillte identifikimin e problemeve dhe dhënien e zgjidhjeve të mundshme për to;

Duhet të hartohet një plan i integruar për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme të kanalizimeve dhe për të menaxhuar ujërat e ndotura në mënyrë më efektive në Njësinë Administrative Portëz dhe njësitë e tjera administrative, ku mungon sistemi i kanalizimeve

Është e rëndësishme të ndërgjegjësohet dhe trajnohet komuniteti në lidhje me rëndësinë e trajtimit të ujërave të ndotura. Për më tepër sygjerohet që të bëhet matja e ndotjes së tokës, matja e ndotjes së burimeve ujore dhe identifikimi i rrezikut që kjo ndotje sjell tek shëndeti i komunitetit;

Të hartohen plane menaxhimi për dunat ranore që përfshijnë monitorimin e rregullt, masat mbrojtëse të përshtatshme, rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi i komunitetit lokal për rëndësinë e dunave ranore; Të vlerësohet mundësia e angazhimit dhe zhvillimit të takimeve me përfaqësues të KKSHC dhe KKIE si mekanizma që ofron kuadri ligjor, me qëllim nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile;

Të vlerësohet nevoja për projekte në lidhje me:

energjinë e rinovueshme, kryesisht energjinë e prodhuar nga dielli;

menaxhimin e riskut ndaj fatkeqësive;

thatësinë dhe nxehësinë në zonat urbane dhe thatësinë dhe problematikat e bujqësisë në zonat rurale, si dhe shtimi i incidencës së zjarreve. Gjë që po bëhet më tepër evidente me shtimin e efekteve të ndryshimeve klimatike;

ndalimin e prerjes së pakontrolluar të pyjeve dhe mbështetjen e nevojës për pyllëzimin e tyre;

ndërgjegjësimin e komunitetit dhe adresimin e pasojave që vijnë nga ndryshimet klimatike, si p.sh. ndryshime në sasinë e rreshjeve dhe rritje të menjëhershme të temperaturave, duke shkaktuar përmbytje dhe thatësira;

matjen qartë të dëmeve që HEC-et kanë në biodiversitet, që llobojnë për adresimin e kësaj çështje dhe që krijojnë plane për restaurimin e habitateve;

ndërgjegjësimi i komuniteteve të zonës mbi ndërtimin e HEC-eve dhe dëmet që sjellin në biodiversitet.

Dhënia e ekspertizës për krijimin e planeve të ndryshme që nevojiten nga bashkitë duke përdorur kapacitetet e OSHC-ve për të krijuar bashkëpunim me bashkitë;

GreenAL të krijoj sinergji me EU4RIVERS dhe EU4NATURE për të shmangur dublikimin e projekteve dhe shmangien e projekteve që mund të bien ndesh me njëri tjetrin.

Përmbledhje Narrative e takimeve me grupet e interesit.

Gjatë muajit Maj, në kuadër të projektit GreenAL- Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile, u zhvilluan një sërë takimesh me përfaqësues të institucioneve publike në nivel lokal dhe në atë qendror. Këto takime kishin si qëllim njohjen e institucioneve me projektin, fushat dhe projektet potenciale që mund të bashkëpunohet me OshC, si dhe arritjen e një dakordësie për të patur mbështetjen e institucioneve publike gjatë implementimit të projektit. Gjithësej u zhvilluan rreth 14 takime, kryesisht me bashki (11 bashki) si dhe me institucione të tjera të nivelit qendror (rreth 4 takime). Në këto takime morën pjesë 22 persona, nga të cilët 32% ishin burra dhe 68% ishin gra. Pas njohjes me projektin, secili nga aktorët dha një kuptim të përgjithshëm sa i përket problematikave më kryesore në nivel bashkie dhe kombëtar.

Bashkia Belsh, me përfaqësues z.Alberto Hysa, shprehu interesin dhe mbështetjen e tij dhe institucionit që ai përfaqëson sa i përket bashkëpunimit që mund të kenë Organizatat e Shoqërisë civile me bashkinë. Z.Hysa dha një kuptim të përgjithshëm të problematikave kryesore mjedisore në bashki, duke u ndalur më gjerësisht në problematikën e ndotjes së liqeneve, duke qenë se bashkia ka një numër të madh të liqeneve në territorin e saj. Gjithashtu shprehu shqetësimin e tij në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe ndotjes që ato shkaktojnë, problematikë që haset në çdo bashki me të cilën kemi zhvilluar takime.

Personi i kontaktit Bashkia Belsh - hysaalberto5@gmail.com

Bashkia Fier, me përfaqësiuese Znj.Roventa Sera, paraqiti në linjë të përgjithshme fushat e interesit dhe bashkëpunimit potencial me OSHC, duke u fokusuar në sektorin pyjor. Znj.Sera shpjegoi se fushat e bashkëpunimit të OSHC me bashkinë Fier janë të shumta, por ajo i vendos theksin nevojës për Hartimin e Planeve të menaxhimit të ekonomive pyjore dhe nevojës për ndërgjegjësimin e komunitetit që banojnë pranë fondit pyjor, sidomos gjatë sezonit të zjarreve. Gjithashtu problematikë e bashkisë Fier është edhe ndotja nga subjektet (inertet) si dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për ndjeshmërinë mjedisore

Personi i kontaktit Bashkia Fier - roventa.shanisera@gmail.com

Nga Bashkia Krujë morën pjesë Z. Florind Cerhozi - Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Krujë, Z. Roland Daja - Përgjegjës i Shërbimeve Publike që mbulon pjesën e pastrimit dhe mbetjeve, Z. Artan Gjergji - Përgjegjës i Rugëve Rurale, Znj. Klaudia Ziri - Specialiste e Bordit të Kullimit si dhe Z. Xhulian Kafexhiu - Përgjegjës i Zyrës së Informacionit dhe Njësisë së Integritimit në BE. Secili nga pjesëmarrësit solli në vëmendje problematikat kryesore mjedisore të Bashkisë Krujë dhe shprehën interesin dhe mbështetjen e tyre dhe të institucionit që përfaqësonin sa i përket bashkëpunimit që mund të kenë me Organizatat e Shoqërisë Civile. Problematikat mjedisore të përmandura përfshijnë menaxhimin e mbetjeve urbane, rehabilitimin e zones së Mbrojtur të Krastes së Krujes, që është një zonë e mbrojtur. Gjithashtu haset problematika e monitorimit të ndotjes që sjellin lumenjtë (Lumi i Zezës, Gjolës dhe Lumi Ishëm) si dhe sensibilizimi i zonave rurale dhe bizneseve që ti mbajnë pastër ato.

Personi i kontaktit Bashkia Krujë - [xx](#)

Nga bashkia Lushnje mori pjesë Znj.Irena Sinani me pozicion specialist në sektorin e mjedisit. Znj.Sinani shprehu interesin dhe mbështetjen e saj dhe institucionit dhe dha një kuptim të përgjithshëm të problematikave kryesore mjedisore që ka bashkia Lushnje. Theksi në takim u vendos tek rehabilitimi i venddepozitimeve kryesisht në lagjen 18 dhe përmirësim të infrastrukturës të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Nga Znj. Sinani u sugjeua gjithashtu edhe një stacion kompostimi të mbetjeve organike, kryesisht për mbetjet që gjenerohen nga serat. Sa i përket gjendjes së mjedisit, propozohet vlerësim i

gjendjes së tokave, me fokus monitorimin e ndotjes nga përdorimi i pesticideve, si dhe monitorime të lumenjve (shkarkime apo erozion). Për këtë, është i nevojshëm edhe edukimi i fermerëve dhe komunitetit sa i përket sensibilitetit mjedisor.

Personi i kontaktit Bashkia Lushnje - irena.sinani@hotmail.com

Takimi me bashkinë Roskovec me përfaqësuese Znj.Rezarta Blido, kishte në fokus monitorimin e ndotjes kryesisht nga sektori hidrokarbur. Znj.Blido shpjegoi se kishte një ndotje të madhe të pamonitoruara nga pusët e hapura të naftës si dhe nga industria naftënxjerrëse. Gjithashtu, Znj.Blido u ndal tek rehabilitimi lumit Seman, duke shfaqur problematikën e ndotjes dhe erozionit. Sa i përket menaxhimit të mbetjeve, bashkia Roskovec ka gati Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, por nuk është i miratuar, kjo për shkak se bashkisë i mungon Vlerësimi Strategjik Mjedisor.

Personi i kontaktit Bashkia Roskovec - Rezarta.Blido@bashkiaroskovec.gov.al

Bashkia Patos, me përfaqësuese Znj.Blerina Laçi- përgjegjëse sektori mjedis dhe Znj.Valbona Semanjaku-specialiste mjedisi, kishin përgatitur një dokument me projekte të mundshme që mund të realizoheshin nëpërmjet bashkëpunimit me OSHC. Fushat kryesore ku specialistet ishin fokusuar përfshinin:

- Analiza e ndikimit të ndotjes nga akumulimi dhe përpunimi i hidrokarbureve në ambientin natyror dhe shëndetin e njerëzve.
- Studim dhe projektim i situatës në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz dhe zbutja e ndotjes nëpërmjet bimëve akumuluese të metaleve.
- Projekt pilot për ndarjen e mbetjeve në burim, peshimi dhe promovimi i 3R-ve.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit
- Monitorim i parametrave mjedisor të ajrit, ujit dhe tokës.
- Plan i mbarështimit të pyjeve.
- Ndikimi i ndërhyrjeve mjedisore në ruajtjen e mjedisit natyror dhe biodiversitetit.
- Inovacioni në përdorimin e Energjisë së Rinovueshme për të zvogëluar ndikimin në mjedis.

Gjithashtu, Znj.Laçi dhe Znj.Semanjaku shprehën interesin e tyre dhe të institucionit që përfaqësonin për bashkëpunim me organizatat për të arritur realizimin e këtyre projekteve.

Personi i kontaktit Bashkia Patos - blerina.laci@bashkiapatos.gov.al; valbona.semanjaku@bashkiapatos.gov.al

Bashkia Durrës, me përfaqësues z. Lorenc Facja, Znj.Dorjana Lazi dhe Znj.Etleva Velçani, folën kryesisht për probleme mjedisore që janë problematike prej një kohe të gjatë në bashkinë e Durrësit. Bashkia ka në fokus ndarjen e kanalizimeve të ujrave të zeza nga ujrë të shiut si dhe marrjen e masave për uljen e nivelit të CO2 dhe rritja e eficiencës së energjisë, si; veshje kapot e ndertesave ekzistuese, ndertimet e reja eficiente ndaj energjisë, ndricim eficient. Këto projekte aktualisht po zhvillohen në bashkinë e Durrësit, por ka hapësirë për bashkëpunim dhe me OSHC. Ndër problematikat kryesore të përmendura përfshijnë planin e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe rishikimin e politikave, menaxhimi dhe kompostimi i mbetjeve organike si dhe atyre që vijnë nga bujqësia; ndotja nga ujërat e zeza e kanalebe dhe vijës bregdetare (gjithashtu monitorim i gjendjes dhe nivelit të ndotjes), si dhe nevoja për pyllëzim në zonën e Ishmit dhe shtimin e gjelbërimit në qytet.

Personi i kontaktit Bashkia Durrës – dorjana.lazi@durrës.gov.al ; etleva.velçani@durrës.gov.al

Në takimin koordinues, Bashkia Shijak u përfaqësua nga znj. Denada Erzeni dhe znj.Merushe Keçi. Përfaqësueset e Bashkisë Shijak paraqitën në linjë të përgjithshme fushat e

interesi dhe bashkëpunimit potencial me OSHC, ndër të cila përmendeshin: menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane dhe forcimi i politikave me qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit; menaxhimi dhe monitorimi i nivelit të ndotjes që sjellin lumenjtë që kalojnë në territorin e bashkisë; menaxhimi i mbetjeve bujqësore dhe kompostimi i tyre; Rehabilitim i lumit Erzen dhe monitorim i nivelit të ndotjes në disa pika të tij, si dhe me shumë rëndësi ndërgjegjësimi i komunitetit sa i përket ndjeshmërisë mjedisore. Perfaqësueset e Bashkisë Shijak gjithashtu shprehen se nuk i kanë kapacitetet e nevojshme për hartimin e planeve vendore dhe planeve të veprimit, dhe për këto mund të bashkëpunojë me OSHC-të lokale.

Personi i kontaktit Bashkia Shijak- xx

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar gjithashtu edhe takime me institucione publike në nivel kombëtar si Agjencia Kombëtare e Mjedisit apo Instituti i Shëndetit Publik.

Përfaqësuesi nga OSCE, Z.Elton Qendro dha një informacion të përgjithshëm mbi OSCE dhe praktikat ku mbështet operimin e saj. Z.Qendro foli gjithashtu për Grupin Këshillimor Kundër Krimit Mjedisor, grup i cili prej një kohe të gjatë është funksional dhe trajton në mënyrë periodike tematika dhe probleme të ndryshme mjedisore. Pjesë e këtij grupi janë një rrjet kombëtar organizatash së Shoqërisë Civile, të cilat mund të jenë pjesë e skemës së granteve të GreenAL. Z.Qendro shprehu se projekti do të ketë mbështetjen e OSCE dhe dha gjithashtu disa ide bashkëpunimi midis OSCE dhe organizatave implementuese.

Personi i kontaktit OSCE – Elton.Qendro@osce.org

Përfaqësuesja nga Instituti i Shëndetit Publik, Znj.Lindita Molla. Znj.Molla dha një informacion të përgjithshëm mbi ISHP dhe departamentet përbërëse të tij. Gjithashtu, Znj. Molla shprehu interesin dhe mbështetjen e saj dhe institucionit që përfaqësonte sa i përket bashkëpunimit që mund të kenë me Organizatat e Shoqërisë Civile. ISHP mund të ofrojë asistencë teknike, të kryej vlerësime apo edhe analiza të nevojshme sa i përket ndotjes dhe komponentëve përbërës të saj. Znj.Molla u shpreh se janë disa sektorë me të cilat OSHC-të mund të bashkëpunojnë me Institutin e Shëndetit Publik. ISHP mund të ofrojë asistencë për analiza laboratorike (në ndërtim edhe një laborator i ri); kryej studi,e në bazë intersash apo kërkesash në rrugë zyrtare. Znj.Molla dha gjithashtu disa pika të cilat i mendon si problematike dhe që kanë nevojë për adresim, siç janë mbetjet, waste water, rezistenca antimikrobikeve; hartim manualesh dhe udhëzuesish mbi cilësinë e ajrit, sigurinë e ujit dhe sigurinë ushqimore në kuadër të Ndryshimeve Klimatike; vlerësimi i AMR (Rezistences Anti Mikrobiale) në mbetjet ujore si dhe vlerësime mjedisore dhe epidemiologjike të zonave të përkufizuara si HOT SPOT dhe zona të tjera me risk të lartë në shëndetin e popullatës. Gjithashtu, mund të ohrohen ekspertiza dhe konsulenca në gjithë fushat e mësipërme, duke përfshirë edhe fushën e kimikateve.

Personi i kontaktit ISHP – linditamolla@gmail.com

Përfaqësuesja nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Znj. Enkeleda Shkurta u shpreh se bie parimisht dakord që AKM të ofrojë mbështetje dhe mundësi bashkëpunimi me OshC-të mjedisore, kryesisht në rastet kur projekt propozimet mund të kenë të bëjnë me ndërgjegjësimin e publikut mbi qeset plastike ose në zonat problematike të ndotura për indikatorë të caktuar (ajer, Uje, toke). Gjithashtu, Znj. Shkurta u shpreh se AKM mund të asistojë OshC-të nëpërmjet ekspertizës së specialistëve, të kryej vlerësime apo edhe analiza të nevojshme sa i përket ndotjes dhe komponentëve përbërës të saj.

Personi i kontaktit AKM – enkeleda.shkurta@akm.gov.al

Përfaqësuesja nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, Znj. Romina Koto vë në dukje ekspertizën e institucionit të tyre në monitorimin e mjedisit dhe në disa fusha prioritare, që janë gjithashtu tematika kryesore të GreenAL. Ndër to mund të përmendim:

- Monitorim të cilësisë së ajrit (kryesisht për praktikë studentore, publikime të dhënash në formë artikujsh)
- Monitorim të cilësisë së ujit:
 - në laborator (cilësia, sedimentet)
 - në ish-laborator Covid (tashmë përdoret për të analizuar antibiotiko-rezistencën në trupa ujorë)
- Monitorime të ndotjes akustike etj.

UBT i raporton gjetjet nga monitorimet tek organet kombëtare përgjegjëse dhe publikon kërkime në platformën e tyre UBGreen. Ata janë të përfshirë në projekte të tilla si monitorimi i lumenjve, iniciativat e ekonomisë qarkulluese dhe kthimi i ujërave të zeza në biogaz, duke demonstruar një përkushtim ndaj praktikave të qëndrueshme. Znj. Koto tregon se UBT është i hapur për partneritete me OSHC-të, duke theksuar mundësitë për përpjekje të përbashkëta në trajtimin e çështjeve mjedisore duke përfshirë studentët në praktika praktike dhe projekte.

Personi i kontaktit UBT – romina.koto@gmail.com

GreenAL

Raport mbi tryezat e rrumbullakëta dhe takime me grupet e interesit.

RAJONI VERIOR

Korrik, 2024

Përmbledhje Narrative e Tryezave të Rrumbullakëta.

Në rajonin verior, që përfshin Qarqet Shkodër, Lezhë, Dibër dhe Kukës janë zhvilluar në muajin maj 3 Tryeza të Rrumbullakëta:

14.05.2024 – Shkodër (me grupe interesi që veprojnë në Qarkun Shkodër dhe Lezhë)

24.05.2024 – Peshkopi (me grupe interesi që veprojnë në Qarkun Dibër)

31.05.2024 – Kukës (me grupe interesi që veprojnë në Qarkun Kukës)

Në tre tryezat e zhvilluara në rajonin verior kanë marrë pjesë:

- **37 OSHC (+2 Co-PLAN & VIS)**
- **10 institucione publike**
 - 7 Bashki (Vau Dejës, Fushë Arrëz, Klos, Mat, Bulqizë, Kukës, Tropojë)
 - 2 AdZM (Shkodër, Dibër)
 - 1 ZVA (Shkodër)
- **1 Institucion akademik**, i vetmi në Rajonin Verior: Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi
- **3 ekspertë mjedisi**
- **2 studentë**
- **2 aktivistë**
- **3 sipërmarrje** (bimësh aromatiko - mjekësore & produkte vendore)

Nga një **total prej 81 pjesëmarrësish** në të treja tryezat e zhvilluara, përqindja mes grave/vajzave dhe burrave/djemve ka qenë thujse e barabartë: **39 gra/vajza (48%)** dhe **42 burra/djem (52%)**, duke pasur një përfshirje gjinore dhe pjesëmarrje në balancë.

Në këto tryeza u diskutuan dhe u evidentuan çështje mjedisore që impaktojnë qarqet e rajonit verior dhe disa nga çështjet dhe prioritetet e nxjerra në pah nga pjesëmarrësit e të treja tryezave janë të paraqitura më poshtë:

- Menaxhimi i mbetjeve nga shkatërrimi i bimëve aromatiko-mjekësore. Duke qenë se djegia e tyre ndot ajrin një propozim për menaxhimin e duhur të tyre do të ishte riciklimi i tyre dhe përdorimi i tyre për burime alternative.
- Një nevojë që ka dalë edhe nga takimet me grupet e interesit (aktorët institucionalë) është ajo e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, çështje ngritur në çdo takim të zhvilluar si edhe në tryezat e rrumbullakëta. Planet e mbarështimit duke qenë një dokument bazë për mbarështimin e pyjeve të hartuara sipas ekonomive pyjore, për njohjen dhe marrjen e të dhënave për tokën, klimën, faunën, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj, si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të ndërthurura të nevojshme silvikulturore janë të rëndësishme për menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkive.

- Menaxhimi i mbetjeve pavarësisht disa përmirësimeve në infrastrukturën për pajisjen me kosha dhe grumbullimin e tyre nga sektori i shërbimeve pranë bashkive mbetet ende një çështje prioritare për t'u adresuar. Zonat rurale vuajnë mungesën e koshave dhe të tërheqjes së mbetjeve nga sektori i shërbimeve për arsye të vështirësisë rrugore dhe mjeteve jo të përshtatshme për këto zona dhe infrastrukturë rrugore. Nevojitet edukim dhe ndërgjegjësim sa i takon rëndësisë së diferencimit të mbetjeve dhe të trajtimit të tyre. Gjithashtu nevojitet që Zonat e Mbrojtura të pajisen me kosha për hedhjen e mbeturinave.
- Ndotja e burimeve ujore, menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të zeza si dhe prezenca e metaleve të rënda dhe e mbetjeve urbane dhe industriale në ujë është një tjetër problematikë e ngritur, së bashku me derdhjen e ujërave të zeza në burimet ujore dhe masat që duhen marrë për trajtimin e ujërave të ndotura. Kjo ndodh për shkak të hedhjes së mbeturinave të ndryshme duke i vënë këto burime ujore në rrezik për një përdorim të qëndrueshëm. Ndotja e burimeve ujore ka pasoja të rënda për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve dhe dëmton ekosistemet ujore dhe biodiversitetin.
- Nevojiten politika dhe masa për trajtimin e ujërave dhe për të ndaluar hedhjen e mbeturinave të ndryshme në burimet ujore. Investime në infrastrukturë për trajtimin e ujërave dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore janë të nevojshme për të luftuar fenomenin. Gjithashtu i një rëndësie të veçantë është bashkëpunimi mes institucioneve dhe aktorëve të tjerë në territor për menaxhimin e mbetjeve dhe hartimi i planeve të menaxhimit për territorin.
- Referimi i shoqatave të shoqërisë civile tek institucionet dhe bashkia për plane të menaxhimit të hartuara më parë dhe të bazuarit e projekteve mbi studime të kryera më parë dhe hartimi i tyre mbi to për ndërhyrje të mundshme përmes projekteve dhe monitorimit.
- Fokus tek pyllëzimet dhe tek ruajtja e fondit pyjor.
- Studime për zëvendësim të sipërfaqeve të mbjella me kultura të reja/varietete të bimëve të egra, divesifikim i sipërfaqeve të mbjella dhe kryerja e studimeve agronomike.
- Krijimi i një infrastrukture të duhur për zhvillimin dhe promovimin e eko-turizmit me qëllim valorizimin e potencialit natyror dhe biodiversitetit përmes hartave të informacionit turistik, hapjes së shtigjeve, rikualifikimit të atyre ekzistuese, sinjalistikë dhe vendosjen e koshave. Promovimi i turizmit të qëndrueshëm në një territor si ai verior me burime natyrore dhe një potencial të jashtëzakonshëm mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e ruajtjes së këtyre burimeve, dhe një ndërthurje e duhur dhe e qëndrueshme midis turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit mund të minimalizojë ndikimin negativ të turizmit në këto zona.
- Përfshirje dhe integrim të studentëve të degëve të ndryshme të lidhura me fushat me interes, në projekte të lidhura me mjedisin dhe turizmin përmes bashkëpunimeve studentë-shoqata. Gjithashtu, mund të jenë të rëndësishme partneritetet me biznese të industrisë turistike dhe mjedisore dhe institucione lokale për të siguruar që studentët të kenë mundësi për të punuar në projekte dhe për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e tyre në këto fusha. Kjo ndihmon në përgatitjen e studentëve për të

qenë novatorë për të kontribuar në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm.

- Diversifikim i programeve të studimit duke përfshirë studentët në projekte që kanë të bëjnë me mjedisin duke ndihmuar kështu në ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Studentët mund të zhvillojnë ide inovative dhe të ndërtojnë projekte që promovojnë praktikën e qëndrueshme në turizëm dhe mbrojtjen e mjedisit natyror. Përfshirja e studentëve në projekte praktike në fushën e mjedisit dhe turizmit u jep atyre mundësinë të zhvillojnë aftësi praktike dhe kritike, duke punuar në projekte konkrete. Përmes studimeve dhe projekteve praktike, studentët mund të identifikojnë dhe të promovojnë potencialet turistike të një rajoni duke përfshirë një qasje të qëndrueshme dhe të përputhshme me mbrojtjen e mjedisit.
- Fokus te frutat e pyllit për t'i valorizuar si nga pikëpamja e ruajtjes së biodiversitetit ashtu edhe nga ana e zhvillimit të komuniteteve që merren me kultivimin dhe përpunimin e tyre.
- Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave: për shkak të një mosmenaxhimi të duhur të tyre është shkaktuar humbja e biodiversitetit, erozioni dhe ndikimi negativ në cilësinë e ujrave. Pakësimi i sipërfaqeve të pyjëzuara ka ndikuar në burimet hidrike dhe tokësore. Zjarret dhe shfrytëzimi jo i duhur i pyjeve ka shkaktuar dëme të konsiderueshme mjedisore dhe humbje të pasurisë natyrore. Investimi në promovimin e praktikave të qëndrueshme të pylltarisë, përfshirë rikthimin e pyjeve të shkatërruara dhe mbjelljen e pyjeve të reja, ruajtja dhe mbrojtja e tyre mund të ndihmojë në ruajtjen dhe rikthimin e biodiversitetit. Problemi i mosmenaxhimit të kullotave ka ndikuar në zhvillimin e blegtorisë. Nevojitet që të nditen të rinjtë për të mos lënë territorin dhe të shohin si mundësi rimarrjen e punës në kullota. Me rëndësi për zbutjen e fenomenit është edhe edukimi dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve mbi rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe kullotave me qëllim ndryshimin e sjelljeve dhe përfshirjes në nisma të angazhimit qytetar. Gjithashtu është e rëndësishme të zhvillohet planifikimi i qëndrueshëm territorial që përfshinë mbrojtjen dhe zbatimin e pyjeve dhe kullotave në hartimin e planeve të zhvillimit.
- Regjistrimi i pronësisë - fondi pyjor. Mungojnë aktet nënligjore për kalimin e së drejtës së përdorimit/pronësisë mbi pyjet dhe kullotat familjeve që jetojnë në zonat rurale. Pronësia do të përkthehet edhe në një vetëdije më të lartë dhe kujdes të shtuar.
- Buxheti publik për mjedisin që të përputhet promovimi me realitetin dhe grumbullimi i të dhënave mjedisore mbi investimet publike për të vlerësuar impaktin mjedisor dhe për të monitoruar performancën e investimeve në projekte mjedisore.
- Përfshirja e të rinjve në nisma mjedisore si aktorë për ruajtjen e mjedisit dhe frenimin e emigracionit.
- Menaxhimi i ekosistemeve në Zonat e Mbrojtura shoqëruar me informim të komunitetit mbi kufijtë dhe menaxhimin e Zonave të Mbrojtura.
- Aktivitete Green me qëllim të dyfishtë: ruajtjen e biodiversitetit dhe përfitimin ekonomik pa ndikuar negativisht, referuar kjo edhe sipërmarrjeve ekzistuese duke l informuar se çfarë është e përshtatshme/e lejuar.

- Valorizimi i bimëve mjekësore, në 360⁰, të cilat kanë vlera të veçanta dhe janë autoktone përmes njohjes, kultivimit, grumbullimit, trajtimit dhe përdorimit të tyre shoqëruar me informim dhe rritje të vetëdijes mbi rëndësinë e tyre.
- Rëndësia e përfshirjes së të rinjve, grave dhe shkollave në aktivitete mjedisore.
- Nxitja e aktivizmit & ngritja e strukturave denoncuese/sinjalizuese. Nevojitet vullnet dhe një plan masash, për të mos ndenjur vetëm në çështje të ndërgjegjësimit por të kalohet në aktivizëm.
- Përfshirja e shkollave në aktivitete edukuese & mjedisore mbi potencialin që zotëron territori për ta përçarur më tej në familje dhe komunitet.
- Erozioni dhe nevoja e ngritjes së pritave, edhe përmes ndërhyrjeve tradicionale që bëheshin dikur.
- Rajoni verior vuan në fondin pyjor nga sëmundjet e grerëzës së gështenjës, procesionarias së pishës dhe fluturës aziatike dhe nevojiten laboratorë dhe nisma për luftimin e tyre.
- Mbrojtja dhe shtimi i sipërfaqeve me bimë endemike në Parkun Natyror Korab – Koritnik.
- Ngritja e barrierave/rrjetave për bllokimin e mbetjeve që vijnë nga vendet fqinj, me angazhim komunitar në bashkëpunim me institucionet për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre.

Përmbledhje Narrative e takimeve me grupet e interesit.

Në rajonin verior janë zhvilluar **22 takime me grupet e interesit**.

Gjatë takimeve të zhvilluara janë takuar përfaqësues të:

- **11 bashkive** (Shkodër, Vau Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Lezhë, Mirditë, Kurbin, Klos, Mat, Kukës, Has) nga 15 në total që ka rajoni verior.
- **3 AdZM** (Shkodër, Lezhë, Kukës)
- **3 ZVA** (Shkodër, Klos, Mat)
- **1 DRAP** (Lezhë)
- **4 Agjentë të Zhvillimit Lokal** (Malësi e Madhe, Pukë, Fushë Arrëz, Vau Dejës, Kukës, Tropojë, Has) të cilët veprojnë si ura lidhëse mes komunitetit dhe institucioneve.

Në total janë **takuar 94 përfaqësues të grupeve të interesit** të sipërpërmendura, nga të cilët **34 gra/vajza (36%)** dhe **60 burra/djem (64%)**.

Nga takimet e kryera me grupet e interesit janë ngritur problematikat mjedisore si më poshtë:

Bashkia Shkodër:

- Mungesa e nje plani 5-vjeçar për cilësinë e ajrit.
- Kompostimi i mbetjeve të gjelbra.
- Pyllëzimi në një mënyrë të qëndrueshme, p.sh. në projekte të mos parashikohet vetëm mbjellja e fidanëve por edhe shërbimi për të paktën 3 vite, që fidanët të mos dëmtohen dhe financimet të jenë pa rezultat.
- Nevoja për trajnime dhe ndërgjegjësim të komunitetit se si të mbrojnë pyjet.

Bashkia Vau Dejës

- Pastrimi i pyjeve, gjë e cila shërben për shtimin e tyre por edhe për mbrojtjen nga zjarri.
- Pyllëzimi në disa vende që është një nevojë emergjente për të parandaluar erozionin.
- Sëmundja e gështenjave dhe procesionaria e pishave.
- Pikat e depozitimit të mbetjeve, një problem tepër serioz në territorin e Bashkisë Vau Dejes, pasi ato në të shumtën e rasteve përfundojnë edhe në liqen.
- Ndotja e ujërave nëntokësore nga fabrika e hershme e përpunimit të bakrit, problem për të cilin nevojitet ndërhyrja në të gjitha kanalizimet.
- Mungesa e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, të cilat janë të domosdoshme edhe për ligjin por edhe për punën praktike në terren, të cilat aktualisht mungojnë.

Bashkia Pukë

- Menaxhimi i mbetjeve nuk behet sipas kriterëve për shkak të mungesës së nje venddepozitimi të pershtatshem.

- Ripyllezimi me peme frutore apo te dobishme per banoret, si: lis, ah, geshtenja, arra, akaçie, sallgam qe perdoret si ushqim nga bletet (familjet ne Bashkine Puke po e shtojne shume numrin e koshereve), etj., pasi 60-70% e territorit eshte me pishë qe perveç bukurise natyrore, nuk ka asnje perdorim tjeter per banoret. Por pyllezimi te behet nen nje kujdes te vazhdueshem, pasi ne çdo mbjellje 20-30% e fidanave firon.
- Mungesa e Planeve 10-vjeçare te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave (Puka ka 20 Njesi Ekonomike).
- Proesionaria e pishës e cila demton fondin pyjor dhe nevoja per te marre masa per luftimin e saj.
- Ndotja e shkaktuar nga miniera e bakrit.
- Hedhja e ujerave te zeza ne rezervuarin e Kukajve dhe nevoja per vendosjen e tabelave sinjalizuese duke qene nje zone qe frekuentohet nga turiste.
- Shenjimi, vendosja e tabelave dhe digjitalizimi i shtigjeve për zhvillimin dhe promovimin e eko-turizmit.
- Shtimi i brezave te luleve dhe i hapësirave rekreative dhe vendeve per piknik.
- Blerja e koshave te medhenj dhe te vegjel per qendrat e banuara dhe per oborret e shkollave.
- Nje problematikë eshte edhe erozioni i larte.

Bashkia Fushë-Arrëz

- Problematika e parë e ngritur ishte ajo e ndotjes së lumit Fan i Madh, per te cilen eshte lobuar edhe ne fazën paraardhese të Green AL, per te cilen na vune ne dijeni se tanime masat ligjore per ndotjen e ujerave jane ashpersuar dhe e konsiderojne terthorazi si nje rezultat pozitiv edhe lidhur me fushaten lobuese permes projektit të zbatuar.
- Nje problematike tjeter e ngritur eshte çeshtja e pyjeve, jetike per ndikimin qe kane ne ndryshimet klimatike. Reduktimi i fondit pyjor ndikon ndjeshem ne ndryshimet qe po ndodhin me klimen, i shkaktuar kryesisht nga zjarret, por edhe prerjet dhe proesionaria e pishes.
- Mungesa e Planeve të Mbareshtimit, qe ndikon ne menaxhimin e fondit pyjor, per te cilat bashkia eshte duke u perpjekur t'i beje me fondet e veta, por kostoja eshte teper e larte, pasi buxheti i bashkise eshte i vogel ndersa posedon 19 Njesi Ekonomike (aktualisht bashkia po pergatit Planin e Mbareshtimit per Njesine Kryezi).
- Nevoja per investim ne infrastrukturen per mbrojtjen nga zjarret, p.sh. ndertimi i lerave, ndertimi i kullave te vrojtimit, blerja e paisjeve moderne per shuarjen e zjarreve, siç eshte pompa fikese me ajer (jo me uje). Kete vit eshte rritur edhe numri i vrojtuesve te pyjeve, do te jene 6 vrojtues dhe nderkohe qeveria do te nderhyje edhe ne masat ligjore ndaj demtimit te pyjeve. Investimi ne kete çeshtje eshte lufta me e mire ndaj ndryshimeve klimatike.

- Ndotja dhe riciklimi eshte nje tjetër problem ne kete komunitet, per te cilat ndergjegjesimi eshte shume i ulet dhe nevojiten fushata ndergjegjesimi, sidomos per reduktimin e plastikes.
- Venddepozitimi i mbetjeve nuk eshte sipas kritereve duke krijuar nje problem mjedisor dhe mundesia per t'i derguar mbetjet ne landfillin e Bushatit eshte e vogel pasi ka shume kosto
- Nevoja per hartimin e Planeve te Mbareshtimi per Pyjet dhe Kullotat, mungesa e te cilat ndikon edhe ne perthithjen e fondeve.

Bashkia Lezhë

- Mungesa e planeve 10 vjecare te mbareshtimit te pyjeve per 6 njesite ekonomike qe ka Bashkia Lezhe, ku aktualisht ata jane duke hartuar nje plan per Njesine Ekonomike Zadrime (Blinisht dhe Kallmet). Planet e hartuara do te publikohen ne faqen e bashkise dhe ne faqen e ALFIS dhe do te jene te aksesueshme per te gjithë te interesuarit. Pa hartimin e planeve nuk mund te behet asnje nderhyrje, prandaj kjo eshte nje nevojë emergjente per kete territor.
- Nevoja e nje studimi se si te mbrohemi nga erozioni detar qe çdo vit po rritet ndjeshem nga mungesa e dunave ranore.
- Ndertimi i pritave malore apo ndotja ne plazhe.
- Menaxhimi i mbetjeve sidomos ne vijen bregdetare per shkak të mungeses dhe numrit të ulet te koshave dhe vendosja e tabelave sinjalizuese për mbrojtjen e mjedisit dhe rëndësinë e mbajtjes paster te tij.
- Promovimi i resurseve historike, kulturore dhe gastronomike per zhvillimin e nje turizmi te qendrueshem.
- Ulja e ndotjeve ne mjedis dhe rritja e mekanizmave mbrojtës per natyren dhe biodiversitetin.

Bashkia Mirditë

- Mungesa e Planeve te Mbareshtimit per Pyjet dhe Kullotat (Bashkia Mirdite ka 21 Njesi Ekonomike).
- Mungesa e nje Plani Menaxhimi per Mbetjet e Ngurta, qe eshte nje nga ndotjet kryesore ne kete territor, dhe e nje plani per mbetjet elektrike.
- Procesionaria e pishes dhe nevoja per te marre masa per luftimin e saj.
- Pyllezimi (sekuestrimi i karbonit) gjithashtu eshte shume i nevojshem edhe ne Bashkine Mirdite dhe nje mundesi e mire do te ishte ngritja e nje fidanishteje atje.
- Mungesa e korridoreve pyjore per mbrojtjen nga zjarret dhe nevoja per hapjen e tyre.
- Fushata ndergjegjesimi per menaxhimin me te mire te mbetjeve inerte nga komuniteti.
- Nje mangesi e Bashkise Mirdite ishte pamundesia per te mbuluar te gjithë territorin me sherbimin e pastrimit te mbetjeve urbane sepse nje pjese e madhe

e fshatrave jane te paasfaltuar dhe atje nuk mund te arrije makina teknologjike e bashkise.

- Nxitja e perdorimit te energjise se rinovueshme.
- Sistemi i ujerave te zeza.
- Bashkia Mirdite ka mungese te organizatave aktive të shoqerise civile.

Bashkia Kurbin

- Menaxhimi i mbetjeve sidomos ne qender te Laçit dhe rruges per te Kisha e Shen Ndout per shkak se nuk ka aktualisht dhe nevojiten kosha te vegjel metalike.
- Nevoje per zhvillimit te turizmit, nje sektor i pa zhvilluar ne kete bashki, nderkohe qe ka jo pak potencial, duke filluar me pasurite kulturore, historike, natyrore, etj. E vetmja zone disi me e njohur dhe e vizituar eshte Laguna e Patokut, turizmi kulinar dhe zona e Laçit, turizmi fetar ne periudhen Mars – Qershor qe jane te martat e Shen Ndout.
- Nje problem serioz mjedisor eshte grykederdhja e Lumit Ishem, e cila derdh ne det nje sasi jashtezakonisht te madhe plastike. Njera ane e lumit (Bashkia Durres) sherben per plazh, ndersa ana tjetere e lumit (Bashkia Kurbin) sherben per mbetjet e plastikes. Problemi i ndotjes se mjedisit nuk mund te rregullohet nese nuk fillon aplikimi i gjobave per ndotesit.
- Mungesa e Planeve te Mbareshtimit te Pyjeve.
- Mungesa OSHC-ve lokale me fokus mjedisor dhe OSHC-te lokale qe jane nuk kane akoma nje pervoje te mjaftueshme per te menaxhuar fonde te medha.

Bashkia Klos

- Ndotja e lumit te lugines Mat duke shmangur derdhjen e mbetjeve dhe marre masa per pastrimin, duke qene burim kryesor. Nevoja per tabela ndergjegjesuese pergjate lumit ne pika te nxehta.
- Mungesa e impianteve te trajtimit per burimet ujore.
- Menaxhimi i mbetjeve – mungesa e nje venddepozitimi te pershtatshem, legal e te miremenaxhuar dhe veshtiresia e grumbullimit te mbetjeve ne zonat rurale per shkak te infrastruktures rrugore te veshtire makina teknologjike e ka te pamundur dhe numri i ulet i koshave ne zona. Mbulimi ne zona rurale i pastrimit eshte 40% ndersa ne qytet eshte i mbuluar teresisht (200 kosha). Ne Qafe Bullit ekziston nje pike e perbashket venddepozitimi te hapur per depozitimin e mbetjeve te Klosit dhe Bulqizit.
- Prerja e paligjshme e pyjeve dhe mbrojtja e pyjeve nga semundjet (procesionaria).
- Nevoja per rehabilitim te pyjeve – shume territor me siperfaqe te djegura dhe nevoja per ripyllzim.
- Mungesa e planeve te mbareshtimit te pyjeve qe do te ndihmonin ne planifikimin e ndërhyrjeve ne ekonomi pyjore.
- Mungesa e zhvillimit te turizmit te qendrueshem ne zone.

Bashkia Mat

- Pakesimi i siperfaqeve te pyllezuara me ndikim ne burimet hidrike, tokesore. Nevoja per rehabilitim dhe pyllezim.
- Mungesa e planeve te mbareshtimit te ekonomike pyjore per te zhvilluar aktivitetet qe mund te ushtrohen per permiresimin e pyjeve.
- Ndotja e burimeve ujore dhe nevoja per trajtimin dhe pastrimin e tyre.
- Nevoja per zhvillimin e metejshej te turizmit ne zone, e pasur me potenciale natyrore e kulturore permes pastrimit te stigjeve, tabelave ne site arkeologjike, promovim. Eshte me i zhvilluar turizmi i aventures dhe synohet edhe zhvillimi i atij natyror.
- Mungese e pranise se organizatave mjedisore te shoqerise civile.

**Nje praktike e mire qe po zhvillohet ne Burrel eshte ajo e grumbullimit te mbetjeve dere me dere, ne dy orare te caktuara. Eshte nje nisme qe eshte mirepritur nga komuniteti.*

Bashkia Kukës

- Ndotja e burimeve ujore duke qene se liqeni kufizohet nga 5 bashki dhe ne zone nderkufitare duke sjelle prurjet e mbetjeve nga me shume se nje burim. Pervet plastikes, problematike eshte edhe baseni ujembledhes.
- Derdhja e ujerave te zeza (qyteti i Kukesit + fshatrat) dhe trajtimi i ujerave te ndotura.
- Menaxhimi i mbetjeve: infrastruktura me kosha eshte e ngritur, por ne zonat rurale eshte e veshtire grumbullimi per shkak te infrastruktures rrugore. Nevoja imediate mbetet trajtimi i tyre. Nevoja e vendosjes se koshave ne zonat e mbrojtura.
- Mungesa e planeve te mbareshtimit.
- Regjistrimi i pronave – fondi pyjor, pasi ne harkun kohor 1985-2020 siperfaqet pyjore kane pesuar ndryshime.
- Semundja e flutures aziatike e cila pothuajse ka shkaterruar komplet bushin.
- Duke qene ne plan ngritja e nje landfilli me fondet e BE, nevojitet ndergjegjesim per grumbullimin e ndare te mbetjeve dhe pajisja me kosha per grumbullimin e tyre.

**Nje praktike e mire per grumbullimin e mbetjeve ne liqen eshte venia ne funksionim e nje anije e cila del disa here ne dite per grumbullin e mbetjeve me qellim pastrimin e liqenit dhe reduktimin e mbetjeve, permes nje marreveshje mes bashkise dhe kompanise.*

Bashkia Has

- Menaxhimi i mbetjeve dhe prania e venddepozitimit ne Krume, zone e banuar, nevoja per zhvendosje larg zones se banuar.
- Ndotja e liqenit dhe e burimeve ujore.
- Mungesa e tabelave informuese.

**Bashkia Has eshte duke lobuar per ta shpallur Pashtrikun park kombetar dhe kane hartuar nje draft plan. Gjithashtu kane nje plan per zhvillimin e turizmit ne disa zona/fshatra (sinjalistike, pastrim).*

AdZM Shkoder

- Proesionaria e pishes & Grezeza e geshtenjes
- Shembja e kullave te vrojtimit dhe ristrukturimi dhe ngritja e tyre
- Nevoja per investime konkrete ne zonat e mbrojtura
- Propozim që grantet te kene nje fond te percaktuar per investime ne zonat e mbrojtura
- Aplikuesit te jene te detyruar qe ne projektet e tyre te bashkepunojne me institucionet publike te specializuara ne fushat perkatese, pasi ne kohet e fundit kane filluar ta anashkalojne partneritetin me ta.

AdZM Lezhë

- Kune – Vain eshte zona me e prekur nga ndotja mjedisore, pasi lumenjte Mat dhe Drin sjellin shume prurje dhe si rrjedhoje, edhe shume ndotje, veçanerisht grykederdhja e Drinit, te cilat per fat te mire nuk vijne nga banoret por nga prurjet e burimeve te tjera ujore.
- Mungesa e rrjetave ne grykederdhje dhe nevoja per vendosjen e tyre, nje praktike e zbatuar me pare nga nje organizate, ku te vetmin problem kishte mungesen e qendrushmerise, pasi ato rrjeta duheshin ruajtur dhe pastruar here pas here nga bashkia, gje qe nuk ndodhi, dhe tani ato i kane hequr peshkataret sepse sipas tyre bllokoni peshkun.
- Nje problem tjetër i rendesishem ne zonen e mbrojtur Kune – Vain eshte qe nuk funksionojne kanalet kulluese, uji nuk qarkullon dhe per me teper te gjitha ujerat e zeza derdhen ne keto kanale. Zgjidhja e vetme per kete problem eshte te pastrohen grykat here pas here, p.sh. Gryka e Matkeqes ka nevojë per nje barriere/skarpate per ta mbajtur te hapur sepse mbyllet, pra kanali duhet te vishet me gure ne te dyja anet. Te gjitha grykat ekzistuese duhet te mirembahen nga qershori deri ne shtator, periudha ku ka me pak prurje uji sepse ne muajt tjere rrjedha e ujit i mban vete te hapura. Kjo eshte nje pergjegjesi e Bordit te Kullimit, por qe aktualisht puna nuk po behet si duhet.
- Probleme tjera jane hidrovoret qe tani derdhen ne lagune ndersa perpara derdeshin ne det dhe shtimi i erozionit qe vjen si pasoje e zhdukjes pothuajse te plote te dunave ranore per shkak te urbanizimit dhe aktiviteteve te njeriut; Tani baticat hyjne me thelle ne toke dhe kjo ka rritur ndjeshem zonen e kripezimit, prandaj do te ishte e nevojshme te hapeshin puse uji te embel.
- Mungesa e sinjalistikes dhe mirembajtja e shtigjeve p.sh. ne Kune, ose mbjellja e pishave. Duhet te theksojme se mbjellja e pishave eshte e veshtire, pasi ato duhen mirembajtur deri qe te mbijne sepse perndryshe shumica thahen.

- AdZM zhvillon neper shkolla oret e edukimit mjedisor, nje aktivitet i mire dhe i nevojshem per femijet por realizimi eshte disi i veshtire sepse pavaresisht se ky eshte nje program i Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit ne anen tjetër Ministria e Arsimit nuk lejon aktivite te tilla neper shkolla. Nevoja per nje marreveshje midis ministrive te linjes.
- Mundesia e vizitave te nxenesve te shkollave si ore mesimore ne zonet e mbrojtur.

AdZM Kukës

- Gjatë takimit me drejtorin e AdZM Kukës, pas prezantimit të projektit dhe qëllimit të takimit, ajo që u evidentua si e një rëndësie të veçantë dhe si një sugjerim për t'u marrë në konsideratë ishte t'i jepet rëndësi konsultimit me përfaqësues të AdZM Kukës nga ana e shoqatave të cilat do të synojnë të zhvillojnë projektet dhe aktivitetet e tyre në Zonat e Mbrojtura, për të pasur kështu një mendim dhe një mbështetje të mundshme nga ky institucion, duke u koordinuar mbi aktivite të mundshme që mund të zbatohen në këto zona. Sic edhe ka dalë nga takimet e komitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura kjo është e rëndësishme pasi ndihmon të zhvillohen në territor projekte që janë në përputhje me Planet e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura dhe konform ligjit të tyre, dhe mbi të gjitha pasi në territorin e Zonave të Mbrojtura ky institucion ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur dhe mund t'u ofrojë grantmarrësve potencialë të cilët mund të aplikojnë për projekte në Zonat e Mbrojtura një panoramë të aktiviteteve që janë zhvilluar tashmë në to për të shmangur mbivendosje apo zhvillim aktivitetesh të njëjta. Me një koordinim të duhur mes palëve, do të ofrohet mbështetja nga ana e AdZM Kukës. Z. Gjana sugjeroi që ndër kriteret e thirrjeve të mund të vihet si kriter konsultimi me AdZM Kukes për ndërhyrje të mundshme që aplikantët potencialë mund të parashikojnë brenda projekteve të tyre dhe që mund të zhvillohen në Zonat e Mbrojtura dhe të kenë prioritet ato shoqata që e kanë bërë këtë kalim dhe e kanë marrë një mbështetje të mundshme nga ky institucion.
- Disa nga nevojat e evidentuara nga ky takim ishin:
 - Vendosja e koshave të mbeturinave në Zonat e Mbrojtura.
 - Ndërgjegjësim.
 - Edukim për ndarjen e mbetjeve.
 - Evidentim-Hartim skice të vendeve ku mund të hidhen mbetjet – përcaktimi i pikave të grumbullimit (Parku Korab Koritnik 36 fshatra), të cilat të miratohen nga Bashkia me qëllimin për të hartuar më pas një kalendar sipas një grafiku të caktuar për tërheqjen e mbetjeve.
 - Nevoja për kosha në shtigje dhe vendpushime.
 - Përmirësimi i shtigjeve
 - Tabelat informuese të jenë sipas standarit
 - Mungesa e një qendre vizitorësh dhe e materialeve promovuese
 - Ndërhyrje dhe tabela për mbrojtjen e bimëve

Sa i takon ndryshimeve klimatike, problematika mjedisore për t'u marrë në konsideratë janë:

- pyllëzim.
- sistemim i gardheve me thupra kundër erozionit.
- korridoret në raste zjarri do të ishin një ndërhyrje shumë e domosdoshme.
- duke qenë se bimët mjekësore gjenden në pjesën më të madhe të tyre në zonat e mbrojtura me qëllim ruajtjen e biodiversitetit dhe valorizimin e tyre do të ishte me interes krijimi i skedave biologjike të këtyre bimëve.

AREB Shkoder

Si probleme mjedisore te shkaktuara nga aktivitetet bujqesore jane:

- Ndotja me nitrite dhe plehra kimike nga serat.
- Plehu qe prodhohet nga fermat dhe komplekset e kafsheve, i cili hidhet ne vende te papershtatshme ose ne rruget kryesore duke u kthyer keshtu nje shqetesim serioz per banoret dhe kalimtarët. Problem ky qe do te permiresohet edhe nepermjet ligjit, pasi keta fermere nuk do te marrin mbeshtetje me fonde nga Skemat Kombetare nese nuk vene impiantet e pastrimit dhe nese nuk hapin gropat septike.
- Ndimimi i larte ne bujqesi per shkak te ndryshimeve klimatike.
- Ndotja e tokave bujqesore nepermjet ujitjes permes burimeve ujore te ndotura.

ZVA Shkoder, Klos, Mat & DRAP Lezhë

Ne te katerta takimet e zhvilluara qasja per te bashkepunuar dhe mirepritur projektin ishte pozitive, por sic jemi ne dijeni nga viti 2020 eshte Ministria e Arsimit sipas rregullores institucioni qe lejon ose jo zhvillimin e aktiviteteve ne shkolla.

Me lejimin nga ana e Ministrise, te 4 drejtuesit e takuar u shprehen vullnetplate per t'u vene ne dispozicion dhe per te na mbeshtetur me gjithcka qe eshte e nevojshme ne kuader te nismave qe do te zhvillohen dhe parashikojne perfshirjen e shkollave.

Drejtori i DRAP Lezhe na sugjeroi Znj. Zamira Gjini – Drejtoresha e Arsimit Parauniversitar ne Ministrine e Arsimit per ta takuar dhe dakordesuar mbi nje marreveshje te mundshme.

Oret e edukimit mjedisor te parashikuara ne kurrikulen shkollore mund te jene nje mundesi e mire per te bashkepunuar per aktivitetet ne kuader te Green AL.

Universiteti i Shkodres Luigj Gurakuqi

- Vleresimi i trashegimise kulturore ne aspektin mjedisor.
- Përfshirje dhe integrim të studentëve të degëve të ndryshme të lidhura me fushat me interes, në projekte të lidhura me mjedisin dhe turizmin përmes bashkëpunimeve studentë-shoqata.

- Diversifikim i programeve të studimit duke përfshirë studentët në projekte që kanë të bëjnë me mjedisin duke ndihmuar kështu në ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.
- Principet e edukimit mjedisor në bashkëpunim midis aktoreve të ndryshëm përmes hartimit të një platforme që fillon me një metodologji teorike dhe që perfundon me pilotim praktik me një shkollë, me një bankë, me universitetin, me një biznes.

Agjentët e Zhvillimit Lokal

- Proesionaria e pishes në Puke
- Ndotja e lumit Fan i Madh nga fabrika e bakrit – propozuan ndertimin e një impianti për filtrimin e ujit në distancë nga fabrika në mënyrë që ndotja të mos shpërndahet në të gjithë gjatësinë e lumit.
- Ndotja e liqeneve të Vau Dejes dhe Komanit, e cila vjen nga mbeturinat që hidhen në lumenje dhe perrenje, e që pastaj grumbullohen në liqene – për këtë propozuan vendosjen e rrjetave ndaluese në grykëderdhjet e lumenjeve dhe perrenjeve, të cilat duhet t'i pastroje bashkia në mënyrë periodike ose blerjen e një vaske pluskuese që i mbledh mbeturinat në liqen. Nevoja për aktivitete pastrimi në liqen pasi ndotja e tij ndikon në humbjen e biodiversitetit.
- Zonat rurale dhe lagjet periferike s'kanë rrjet të ujerave të zeza dhe mungon impianti i mirëfillte për menaxhimin e ujerave të zeza.
- Menaxhimi me i mirë i mbetjeve nëpër fshatra.
- Prerja dhe pastrimi i pyjeve për të parandaluar zjarret.
- Pyllezimi nëpërmjet studimeve profesionale në mënyrë që të mbillen variacione të reja pemesh që shtohen dhe rriten me shpejt.
- Një problem i rëndësishëm është erozioni, sidomos në fshatrat: Blerim – Fushe Arrez, Qelez – Puke dhe gjithashtu në Diber.
- Një tjetër problem është ndertimi i hidrocentralit të Skavices, i cili do demtojë shumë toka bujqësore duke i nxjerre nga përdorimi dhe rrezikon shumë fshatra përreth.
- Demtimi i flores dhe faunës nga ndertimin e hecëve.

GreenAL

Raport mbi tryezat e rrumbullakëta dhe takime me grupet e interesit

RAJONI JUGOR

Korrik, 2024

Përmbledhje Narrative e Tryezave të Rrumbullakëta.

COSV ka zhvilluar dy round-table në Rajonin e Jugut, në Vlorë dhe në Pogradec.

Në Vlorë morën pjesë 28 persona (11 meshkuj & 17 femra) pjesëmarrës, përfaqësues nga OJQ-të mjedisore, Qendra Komunitare dhe përfaqësues nga bashkia e Vlorës:

- 1 Turizëm biznesi
- 8 OJQ-të
- 1 Menaxhimi i Integruar i Mbeturinave
- 2 Agjencia Bregdetare Rajonale
- 8 Bashkia e Vlorës, Drejtoria e Mjedisit

Tryeza e rrumbullakët në rajonin jug-lindor u zhvillua me datë 21/05/2024 në zyrën e COSV në Pogradec. Në këto takim morën pjesë 25 persona që përfaqësonin 19 organizata/institucione, prej të cilave:

14 OJQ,
3 institucione publike dhe
2 grupe informale.

Shumica e pjesëmarrësve ishin nga zona e Pogradecit dhe me pak nga Korça ose Berati, përkatësisht Pogradecin 21 persona,
Korça 2 persona dhe
Berati 2 persona.
17 burra (68%) dhe 8 gra (32%).

Pjesëmarrësit theksuan nevojën për të alokuar më shumë burime dhe vëmendje për analizat e ujit të detit dhe liqenit të Ohrid sidomos në lidhje me bakteriologjinë, pasi kjo ndikon drejtpërdrejtë në shëndetin e banorëve dhe turistëve.

Gjatë diskutimeve u theksua rëndësia e monitorimit të Ligjit Nr. 111/2012 për Menaxhimin e Ujit të Përbashkët dhe Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja (Konventa e Barcelonës) e nënshkruar nga qeveria jonë.

Përveç kësaj, guroret vazhdojnë të përbëjnë një problem mjedisor në rajonin e Beratit dhe pjesëmarrësit sugjeruan shtimin e bimësisë rreth guroveve si një praktikë pozitive për të vitalizuar zonën përreth.

Përfaqësuesi i PPNE-së theksoi rëndësinë e të pasurit të dhëna të unifikuara nga të gjitha institucionet që punojnë për mjedisin, pasi kjo jep një pamje më të plotë të nevojave për ndërhyrje.

Së fundi, një shqetësim për qytetin e Vlores, Gjirokastrës dhe Beratit është numri në rritje të qenve të rrugës, të cilët përveçse janë një kërcënim për qytetarët, paraqesin rrezikun e ndotjes së tokës dhe ujit.

Përmbledhje Narrative e takimeve me grupet e interesit.

Nga takimet e zhvilluara me aktorët lokal në Rajonin e Jugut, rezultoi se problemet mjedisore janë shumë të ndryshme dhe komplekse. Shqetësimi mbizotërues i këtij rajoni, është vështirësia e bashkive në menaxhimin e mbetjeve urbane, pasuar nga ndotja e tokës dhe ujit, ndotja e ajrit për shkak të djegieve të ndryshme apo për shkak të gazrave që çliron numri i lartë i automjeteve, etj.

U takuan përfaqësues te institucioneve te ndryshme (11 F dhe 12 M): Universiteti 'Eqrem Cabej', Këshilli Bashkia Gjirokastër, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Administratat e Zonave të Mbrojtura Berat, Pogradec dhe Gjirokastër, Sektori i Ekstensionit Bujqësor, IKMT, specialist të turizmit dhe shërbimeve publike në bashki të ndryshme si: Bashkia Përmet, Bashkia Sarandë, Bashkia Berat, Bashkia Pogradec etj.

Menaxhimi i Mbetjeve Urbane

Ka një mungesë të një infrastrukture të duhur për ndarjen, grumbullimin, menaxhimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane dhe rurale. (Rajoni Gjirokaster, Vlore, Berat, Korçe)

Praktika e djegies së mbeturinave në Gjirokastër dhe Berat si dhe zonat përreth është ende e pranishme, duke shkaktuar ndotje të madhe. Gjithashtu, në zonat malore dhe njësitë administrative të largëta menaxhimi i mbetjeve është problematik, pasi makinat teknologjike shkojnë më rrallë për të pastruar mbetjet. Parqet kombëtare si Mali i Tomorrit, Bredhi i Hotovës, kalaja në Gjirokastër, Banjat e Bënjës kanë mungesë të infrastrukurës së grumbullimit të mbetjeve. Mungojnë gjithashtu pikat e shkarkimit për kamperat që frekuentojnë këto zona.

Landfill-at janë problematike. Nuk ka trajtim të mirëfilltë sipas standarteve evropiane, pasi aktualisht bëhet vetëm ngjeshja dhe mbulimi i mbeturinave. Keto mbeturina lëshojnë liksivate, të cilat shkaktojnë dëme të mëdha në ujerat nëntokësore.

Në Ksamil, bizneset i bëjnë derdhjet e mbeturinave ora e pa orar, pavarësisht se ka një ligj që e përcakton se kur duhet t'i hedhin.

Në asnjë nga bashkitë nuk ka trajtim të diferencuar të mbetjeve spitalore.

Ndotja e Tokës

Përdorimi i plehrave kimike dhe menaxhimi i dobët i tyre kontribuon në ndotjen e lumenjve dhe tokës bujqësore. Djegiet e kullotave dhe mbeturinave bujqësore janë praktika të zakonshme që dëmtojnë mjedisin. (Gjirokastër, Berat, Pogradec)

Mbizotëron mbjellja e misrit për kokërr, e cila pasi korret kryesisht digjet. Gjithashtu për të zgjeruar hapësirat territoriale, ferrat digjen. Për të rikthyer tokën në gjendjen e pershtashme për tu rimbjellë përdoren dy teknika: punimi dhe kthimi i tokës dhe djegia, megjithatë për shkak të kostos më të lartë që ka për burimet njerëzore dhe mjeteve të punës, banorët e zonave preferojnë të djegin. Fermerët nuk bëjnë një menaxhim të mirë të plehrave kimike. I lenë plehrat kimike të grumbulluara në fillim të parcelës, nga aty shkojnë në kanalet ujitëse, pastaj në lumin Osum, Drin, Vjosë dhe në det.

Basenat ujore që grumbullojnë ujrën e zonës, rrjedhimisht grumbullojnë edhe kimikatet. Këto basene përdoren për vaditje, duke e riqarkulluar ndotjen kimike dhe duke e bërë pjesë të produkteve bujqësore dhe ushqimeve.

Toka kur punohet, nuk punohet në lartësinë e izoipseve, por punohet diagonal, duke e prishur humusin.

Gjithashtu, ka ndërtime në toka bujqësore të cilat kanë shtresë të lartë humusi, ku nuk lejohet të ndërtohet. Rrjedhimisht ulet përqindja e sipërfaqes së tokës së punueshme.

Nuk ka thertore të mëdha dhe trajtimi i mbetjeve të kafshëve, pavarësisht se në numër të vogël, janë të pakontrolluara. (Berat, Përmet)

Dëmtimet e Pyjeve

Gjirokastra, Berati dhe Pogradeci vuajnë pasojat e erozionit, për shkak të preresjes së pyjeve për dru zjarri dhe mos ripyllëzimit.

Pylli i Zi në Gjirokastrë është djegur nga shiu acid. Po u dëmtua flora, dëmtohen dhe ekosistemet. Biotopet e kafshëve të egra (derri dhe dhia e egër) janë prishur (Berat). Për më tepër kafshët e egra vriten nga gjuetarët.

Rrapishtet janë të djegura nga masat ajrore të nxehta.

Mali i Gjerë po dëmtohet për shkak të abuzimit që i bëhet marrjes së rrëshirës së pishës, prerjes së ahut dhe shkuljes së shrebelës me rrënjë.

Kurora e geshtenjave rreth rajonit të Pogradecit është pakesuar deri në 60% si rrjedhojë e prerjes dhe mos kujdesit ndaj saj.

Sfida të tjera të mëdha mjedisore në Shqipëri dhe Jugut janë dhe shpimet e predhave në malin e Shpiragut. Gjithashtu, ka një shtim të mbetjeve urbane nga familjet rome që jetojnë aty.

Ndotja e Ajrit

Në Tepelenë, në fshatin Gusmar, emetohen gazra për shkak të karierave të hapura me fosfor, të cilat janë gërmuar gjatë diktaturës dhe nuk janë mbyllur.

Ka ndërmarrje të cilat pas viteve '92 janë të deklaruara si inaktive, godina e uzinës lëkurë-këpucë, prodhimet metalike. Asbesti vazhdon të lëshojë fije në atmosferë, të cilat arrijnë të futen nëpërmjet qarkullimit të gjakut deri në zemër. Karcinoma është një nga sëmundjet që shkaktohet nga ndotja e mjedisit dhe Gjirokastra ka nivel të lartë të ndotjes së ajrit që po ndikon në shtimin e sëmundjeve tumoriale.

Në Sarandë, shkarkimet në ajër bëhen nga bizneset, restorantet, furrat e bukës etj., të cilat ndodhen në zonat e banuara.

Ndotja e Lumenjve

Bizneset derdhin mbetjet në lumin Drino duke dëmtuar jetën e kafshëve dhe bimëve.

Bizneset në Përmet hedhin mbeturina në lumin Vjosa, duke rritur ndotjen nga plehurat kimike. Mungesa e bashkëpunimit institucional dhe fondeve pengon ngritjen e një laboratorit për monitorimin e ujërave.

Ndotja industriale e lumit Osum nga fabrikat e lëkurës dhe vajit, menaxhimi i ujit dhe mbetjeve etj. dhe nga gërmimet në guroret pa leje të Shpiragut.

Ndotja e Detit dhe Liqeneve

Saranda ka kanalizim të mirë, përveç hoteleve të ndërtuara në rrugën kryesore të cilat punojnë me gropa septike apo pompa që i shtojnë ujërat e zeza në rrjet. Prej gropave septike mund të ketë derdhje në det.

Në mesokanal, hapësira detare neutrale, midis Greqisë dhe Shqipërisë, vite më parë ka shërbyer si vend ku derdeshin mbetjet e anijeve. Sot nuk ka informacion të përditësuar nëse derdhen më hidrokarbure apo jo.

Punët ndërtimore që janë duke u zhvilluar vitet e fundit në pjesën e autostradës Ohër-Kërçovë, në afërsi të shtratit të lumit Sateska, kanë ndikimin e tyre shtesë të shtuar në ndotjen e Sateskës, e kështu edhe në liqenin e Ohrit.

Kohë më parë organizatat joqeveritare reagojnë se me miratimin e tekstit të Ligjit për shpalljen e Liqenit të Ohrit monument natyror, Qeveria dhe Ministria e Mjedisit kanë shkelur legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar dhe kanë vepruar në kundërshtim me Kushtetutën.

Ndotja Akustike dhe Energjia

Zona muzeale vuan nga ndotja akustike për shkak të turistëve dhe aktiviteteve të biznesit. (Gjirokastër) Qendra e qytetit në Vlorë ka ndotje të madhe akustike për shkak të muzikës së lartë dhe trafikut të shtuar gjatë sezonit veror.

Eficienca e energjisë në ndërtesat e reja nuk monitorohet sipas standardeve evropiane. Kur jepen lejet e ndërtimit, nuk kërkohet plani i efikasitetit të energjisë nga ndërtuesit (Gjirokastër)

Ka shumë kabuj elektrikë të varur në hapësirën e qytetit të cilët nuk janë të sigurt. Nuk ka mjete apo laboratorë për të matur rrezatimin dhe dëmin që shkaktojnë kabujt elektrikë.

Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore

Janë evidentuar dëme në monumentet kulturore për shkak të erozionit dhe kushteve atmosferike. Ndërhyrjet për ruajtjen e monumenteve dhe sitet arkeologjike janë të domosdoshme por mungojnë fondet dhe pajisjet e nevojshme (Gjirokastër dhe Berat).

Menaxhimi I trafikut

Nevojitet një plan për menaxhimin e trafikut dhe sinjalistikës rrugore. (Përmet, Berat, Vlorë, Pogradec) Shtimi i automjeteve private shkakton dëmtim të cilësisë së ajrit. Mbeten grimca të dioksidit të karbonit, plumbi, sulfuri në ajër dhe në dimër kur bie shi, për shkak të shirave acid dëmtohet bimësia.

Nevojat e Institucioneve Publike

- **Rritje e Kapaciteteve Financiare dhe Teknike:**
 - Nevoja për pajisje dhe laboratorë për të mbledhur dhe analizuar të dhëna mjedisore për të kuptuar më mirë impaktin e ndotjes. (Institucionet Mjedisore, Universitetet)
 - Rritja e kapaciteteve në shkrimin e Planeve Lokale të veprimit sipas nevojave përkatëse të bashkive.
 - Support për hartimin e planit lokal të menaxhimit të zhurmave.
 - Trajnimi i stafeve për shkrimin e projekteve për të përfituar nga fondet e BE-së dhe organizatave të tjera.
 - Shkëmbimi i eksperiencave në mënyrë praktike, në formën e fellowship.

- **Bashkëpunim Institucional:** Shkëmbimi i informacionit në lidhje me çështjet mjedisore midis institucioneve të ndryshme publike për të siguruar pamje të plotë të situatës në kohë reale dhe në nivel kombëtar.
- Angazhimi i shoqërisë civile dhe komunitetit për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ka qenë i pamjaftueshëm për shkak të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të kufizuar
- Bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe pushtetit vendor ka qenë gjithashtu i kufizuar

Disa nga **rekomandimet** e bëra nga të intervistuarit përfshijnë:

1. **Përmirësimi i infrastrukturës dhe menaxhimit të mbeturinave:** Kjo përfshin ndërtimin e vendgrumbullimeve të mbeturinave, sigurimin e pajisjeve për trajtimin e tyre, dhe nxitjen e praktikave të riciklimit sipas standarteve evropiane.
2. Të rikthehet në fuqi plani i menaxhimit për Parkun Kombëtar të Tomorrit i miratuar nga qeveria në vitin 2014 i cili përcakton biznesin e nxjerrjes së gurit si një kërcënim real për habitatet natyrore dhe veçoritë gjeologjike të zonës.
3. **Përmirësimi i monitorimit dhe zbatimit të ligjeve mjedisore:** Është e nevojshme që autoritetet të kenë kapacitetin dhe resurset për të monitoruar zbatimin e ligjeve mjedisore dhe për të dhënë gjopa të forta për ata që ndosin mjedisin.
4. **Ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve:** Për të adresuar shkaqet themelore të ndotjes mjedisore, është e rëndësishme të ketë fushata të përhershme të ndërgjegjësimit dhe edukimit të qytetarëve në lidhje me praktikën e qëndrueshme mjedisore.
Edukimi mjedisor duhet të përfshihet në sistemin arsimor që nga niveli parashkollor.
5. **Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional:** Autoritetet vendore dhe qendrore duhet të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë përpjekjet e tyre për të adresuar problemet mjedisore.
6. **Investime në infrastrukturën mjedisore:** Është e rëndësishme që të bëhen investime në infrastrukturën mjedisore, përfshirë sistemin e kanalizimeve, ndërtimin e stacioneve të trajtimit të ujërave, dhe përdorimin e teknologjisë së pastër për prodhimin e energjisë.
Investime në teknologji të gjelbra si panelet diellore dhe ndriçimi LED.